

[ALBANIAN TEXT — TEXTE ALBANAIS]

**MARREVESHJE NDERMJET REPUBLIKES FEDERALE TE GJER-
MANISE DHE REPUBLIKES SE SHQIPERISE MBI NXITJEN
DHE MBROJTJEN E NDERSJELLTE TE INVESTIMEVE**

Republika Federale e Gjermanise

dhe

Republika e Shqiperise,

me deshiren per te thelluar bashkepunimin ekonomik ndermjet
te dy shteteve,

me synim per te krijuar kushte te pershtatshme per investimet
nga shtetas ose shoqeri te nje shteti ne territorin e shtetit tjetër,

duke e njohur faktin, qe nxitja dhe mbrojtja kontraktuale e ketyre
investimeve jane te pershtatshme per te gjalleruar iniciativen
private ekonomike dhe per te rritur mireqenien e dy popujve,

u muarren vesh si me poshte:

Neni 1

Per qellimet e kesaj Marreveshjeje:

1. Termi "Investim" perfshin vlera pasurore te çdo lloji qe investohen ne perputhje me legjislacionin e brendshem te seciles pale kontraktuese, veçanerisht:
 - a) Pronesine ne sendet e levizeshme dhe te palevizeshme, si te drejta materiale si, hipotekat dhe te drejta pengu.
 - b) E drejta e aksioneve ne shoqerite dhe lloje te tjera pjese-marrjesh ne shoqerite;
 - c) Pretendime per para, qe jane perdorur per krijimin e nje vlere ekonomike ose pretendime per sherbimet te cilat kane nje vlere ekonomike.
 - d) Te drejta te pronesise intelektuale, veçanerisht e drejta e autorit, patenta, mostra perdorimi, mostra tregtare dhe modele, marka, emera tregtare, sekrete te ndermarrjes dhe te veprimtarise ekonomiko-financiare, teknologji, know-how dhe "good will".

e) Te drejta nga marreveshjet e se drejtes publike duke perfshire te drejtat per eksplorimin dhe shfrytezimin, nxjerrjen e pasunive natyrore.

Nje ndryshim i formes ne te cilen investohen vlera pasurore le te paprekur cilesine e saj si investim.

2. Termi "te ardhura" nenkupton ato shuma qe i perkasin nje investimi per nje perudhe kohe te caktuar, si pjeset e fitimit, dividend, interesat, pagesa per licenca ose pagesa te tjera.

3. Termi "shtetas" nenkupton:

a) Ne lidhje me Republiken Federale te Gjermanise:

gjermane ne kuptimin e Ligjit Themelor per Republiken Federale te Gjermanise.

b) Ne lidhje me Republiken e Shqiperise:

shqiptare, ne kuptimin e dekretit Nr. 1874 date 7. 6. 1954.

4. Termi "shoqeri" nenkupton:

a) Ne lidhje me Republiken Federale te Gjermanise:

çdo person juridik si dhe çdo shoqeri tregtare, shoqeri tjeter apo bashkim me ose pa personalitet juridik, e cila ka seline e vet ne territorin gjerman, pavaresisht ne se aktiviteti i tyre drejtohet ose jo mbi bazen e fitimit.

b) Ne lidhje me Republiken e Shqiperise:

çdo person juridik si dhe çdo shoqeri tregtare ose shoqeri tjeter ose bashkim me ose pa personalitet juridik, e cila ka seline e vet ne territorin shqiptar, pavaresisht ne se aktiviteti i tyre drejtohet ose jo mbi bazen e fitimit.

Neni 2

1. Çdo Pale Kontraktuese do te nxise sipas mundesive ne territorin e saj investime nga shtetas ose shoqeri te Pales tjeter Kontraktuese dhe i lejon keto investime ne perputhje me rregullat e saja juridike. Ajo ne çdo rast do te trajtoje investimet ne menyre te drejte dhe te barabarte.

2. Nje Pale Kontraktuese nuk do te preke ne asnje menyre administrimin, perdorimin ose shfrytezimin e investimeve te shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese ne territorin e saj nepermjet masave arbitrare ose diskriminuese.

Neni 3

1. Çdo Pale Kontraktuese i trajton investimet ne territorin e saj te cilat jane nen pronesi ose nen influencen e shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter, ne menyre jo me pak te favorizuar se sa investimet e shtetasve apo shoqerive te veta dhe shtetasve dhe shoqerive te shteteve te treta.

2. Çdo Pale Kontraktuese i trajton shtetasit apo shoqerite e Pales tjeter Kontraktuese, persa i perket aktivitetit te tyre lidhur me investimet ne territorin e saj, ne menyre jo me pak te favorizuar se sa shtetasit dhe shoqerite e veta apo shtetasit dhe shoqerite e shteteve te treta.

3. Ky trajtim s'ka te beje me privilegjet qe nje Pale Kontraktuese i jep shtetasve apo shoqerive te shteteve te treta per shkak te anetaresise se tyre ne nje bashkim doganor ose ekonomik, ne nje treg te perbashket ose ne nje zone te lire tregtare, ose per shkak te asociimit te saj perkates.

4. Trajtimi qe sigurohet ne kete nen s'ka te beje me favorizimet, te cilat nje Pale Kontraktuese u jep shtetasve apo shoqerive te vendeve te treta mbi bazen e nje marreveshjeje per tatimin e dyfishte ose marreveshje te tjera per çeshtje fiskale.

Neni 4

1. Investimet e shtetasve apo shoqerive te nje Pale Kontraktuese gezojne ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese mbrojtje dhe siguri te plote.

2. Investimet e shtetasve apo te shoqerive te nje Pale Kontraktuese ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese lejohen te shpronsohen, te shtetezohen ose t'u nenshtrohen masave te tjera, te cilat ne ndikimin e tyre jane njelloj si nje shpronosim ose shtetezim vetem per te miren e pergjithshme dhe perkundrejt çdemtimimit. Çdemtimi duhet t'i pergjigjet vleres qe ka pasur investimi i shpronosuar menjehere para kohes se shpalljes faktike apo te kercenimit te masave per shpronosimin, shtetezimin ose te masave te ngjashme me to. Çdemtimi duhet te behet pa vonese duke shtuar kamatat ne perputhje me interesat bankare qe jane ne perdorim deri ne kohen e pageses; ai duhet te jete faktikisht i shfrytezueshem dhe lirisht i transferueshem. Jo me vone se ne kohen e shpronosimit, shtetezimit apo masave te ngjashme, duhet te tregohet kujdes i pershtatshem per percaktimin dhe perballimin e çdemtimimit. Ligjshmeria e shpronosimit, shtetezimit apo masave te ngjashme si dhe shuma e çdemtimimit duhet te shqyrtohen nepermjet nje procedure te rregullt ligjore.

3. Shtetasve apo shoqerive te nje Pale Kontraktuese, te cileve per shkak te nje lufte ose konflikteve te tjera te armatosura, revolucionit, gjendje e jashtezakoneshme shtetore ose rebelim ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese u shkaktohen humbje ne investime, Pale Kontraktuese, persa i perket çdemtimit, demshperblimit, çdemtimeve ose sherbimeve te tjera, i trajton ne menyre jo me pak te favorshme se sa shtetasit apo shoqerite e veta. Pagesa te tilla duhet te jene te transferueshme lirisht.

4. Lidhur me çeshtjet qe rregullohen sipas ketij neni, shtetasit ose shoqerite e njeres Pale Kontraktuese gezojne nje trajtim jo me pak te favorizuar ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese se sa shtetasit ose shoqerite e shteteve te treta.

Neni 5

Çdo Pale Kontraktuese u siguron shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese transferimin e lire te pagesave qe kane te bejne me nje investim, veçanerisht sidomos:

- a) te kapitalit dhe shumave shtese per mirembajtjen dhe zgjerimin e investimit;
- b) te ardhurat;
- c) per kthimin e huave;
- d) te fitimit ne rastin e likuidimit te plote ose te pjesshem ose shitjes se investimit;
- e) te çdemtimeve te parashikuara ne nenin 4.

Neni 6

Kur nje Pale Kontraktuese kryen per shtetasit apo shoqerite e saj pagesa per garantimin e nje investimi ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese, atehere pa demtuar te drejtat e Pales se pare Kontraktuese sipas nenit 10, Pala tjeter njeh bazuar ne forcen e ligjit ose te ndonje marreveshjeje juridike, kalimin e te gjitha te drejtave apo pretendimeve te ketyre shtetasve apo shoqerive Pales se pare Kontraktuese. Me tej, Pala tjeter Kontraktuese njeh hyrjen e Pales se pare Kontraktuese ne te gjitha keto te drejta dhe pretendime (kalimin e pretendimeve), te cilat Pala e pare Kontraktuese ka te drejte t'i ushtroje ato ne te njejten mase si paraardhesi i saj juridik. Per transferimin e pagesave per shkak te detyrimeve te mbartura vlejne perkatesisht neni 4 paragrafet 2,3 dhe neni 5.

Neni 7

1. Transferimet sipas nenit 4 paragrafi 2 ose 3, nenit 5 ose 6 kryhen pa vonese me kursin respektiv ne fuqi ne ditën e transferimit.

2. Ky kurs nuk duhet te kete devijime esenciale nga kursi kryq (cross rate), qe rezulton nga ato kurse perlogaritese te cilat do t'u bazoheshin atyre te Fondit Monetar Nderkombetar te monedhave perkatese ne te Drejten e Terheqjes Speciale ne ditën qe kryhen transferimet.

Neni 8

1. Ne rast detyrimesh qe rrjedhin nga dispozitat ligjore te nje Pale Kontraktuese ose nga e drejta nderkombetare, te cilat qendrojne krahas kesaj marreveshjeje midis Paleve Kontraktuese ose qe do te lindin ne te ardhmen, ekziston nje rregullim i pergjithshem ose i veçante, nepermjet te cilit investimeve te shtetasve ose shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese duhet t'u sigurohet nje trajtim me i favorshem se sa sipas kesaj Marreveshjeje, atehere ky rregull i paraprin kesaj Marreveshjeje ne ate mase, qe konsiderohet e favoreshme.

2. Çdo Pale Kontraktuese do t'i permbahet çdo detyrimi tjeter te cilën ajo ka marre persiper lidhur me investimet e shtetasve apo shoqerive te Pales tjeter Kontraktuese ne territorin e saj.

Neni 9

Kjo Marreveshje eshte e vlefshme edhe per investimet, qe kane ndermarre shtetasit apo shoqerite e njerës Pale Kontraktuese ne perputhje me dispozitat ligjore te Pales tjeter Kontraktuese ne territorin e kesaj, qysh para hyrjes ne fuqi te kesaj Marreveshjeje.

Neni 10

1. Mosmarreveshjet midis Paleve Kontraktuese per interpretimin ose zbatimin e kesaj Marreveshjeje duhet te zgjidhen sa te jete e mundur midis qeverive te te dy Paleve Kontraktuese.

2. Ne rast se nje mosmarreveshje nuk mund te zgjidhet ne kete menyre, atehere me kerkesen e njerës prej Paleve Kontraktuese çeshtja u paraqitet arbitrazhit.

3. Arbitrazhi formohet rast pas rasti, duke caktuar çdo Pale Kontraktuese nje anetar dhe te dy anetaret bien dakord per nje perfaqesues te nje shteti te trete si kryetar, i cili caktohet nga

qeverite e te dy Paleve Kontraktuese. Anetaret duhen te caktohen brenda dy muajve, kurse kryetari brenda tre muajve pasi njera nga Palet Kontraktuese ka njoftuar Palen tjetër Kontraktuese se ajo mosmarreveshjet deshiron t'i paraqese arbitrazhit.

4. Ne rast se afatet e permendura ne paragrafin 3 nuk respektohen, atehere ne mungese te nje marreveshje tjetër secila Pale Kontraktuese mund t'i lutet Presidentit te Gjykates Nderkombetare te beje emerimet e nevojshme. Ne qofte se Presidenti eshte shtetas i njerës prej te dy Paleve Kontraktuese ose pengohet per ndonje shkak tjetër, atehere emerimet i ben Zevendespresidenti. Ne rast se edhe Zevendespresidenti eshte shtetas i njerës prej te dy Paleve Kontraktuese ose gjithashtu pengohet, atehere emerimet duhet t'i beje anetari i gjykates ne rang pas tyre dhe qe nuk eshte shtetas i ndonjeres prej te dyja Paleve Kontraktuese.

5. Arbitrazhi vendos me shumice votash. Vendimet e saja jane te formes se prere. Secila Pale Kontraktuese perballon shpenzimet e anetarit te saj si dhe te perfaqesuesve te saj ne proçeduren para arbitrazhit; shpenzimet e kryetarit si dhe shpenzimet e tjera do te perballohen ne pjese te barabarta nga te dy Palet Kontraktuese. Arbitrazhi mund te vendose nje rregull tjetër te shpenzimeve. Perveç kesaj arbitrazhi rregullon vete proçeduren e tij.

6. Ne rast se te dy Palet Kontraktuese jane edhe shtete kontraktuese te Konventes se 18 marsit 1965 per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve lidhur me Investimet midis Shteteve dhe Shtetasve te Shteteve te tjera, atehere duke marre parasysht rregullimin sipas nenit 27, paragrafi 1 te Konventes, arbitrazhi qe parashikohet sa me siper nuk mund te thirret perderisa midis shtetasve dhe shoqerive te nje Pale Kontraktuese dhe Pales tjetër Kontraktuese eshte arritur nje marreveshje sipas percaktimit te nenit 25 te Konventes. Mundesia per thirrjen e arbitrazhit qe parashikohet sa me siper ne rastin e mosmarrjes parasysht te nje vendimi te arbitrazhit sipas Konventes se lartpermendur (neni 27) ose ne rastin e dhenies fuqi te ligjit ose te nje veprimtarie ligjore sipas nenit 6 te kesaj Marreveshje, mbetet i paprekshem.

Neni 11

1. Mosmarreveshjet qe lidhen me investimet midis njerës prej Paleve Kontraktuese dhe nje shtetasi apo nje shoqerie te Pales tjetër Kontraktuese, duhet te zgjidhen midis Paleve qe jane ne konflikt sa te jete e mundur me mirekuptim.

2. Ne rast se mosmarreveshja nuk zgjidhet brenda nje afati prej 6 muaj nga koha e njoftimit te njerës prej Paleve qe jane ne konflikt, atehere me kerkesen e shtetasve ose shoqerise se Pales tjetër Kontraktuese ajo do t'i nenshtrohet nje proçesi arbitrazhi. Ne

rast se Palet ne konflikt nuk bien dakord ndryshe do te zbatohen dispozitat e nenit 10 paragrafi 3 deri 5 ne ate kuptim qe caktimi i anetareve te arbitrazhit sipas nenit 10 paragrafi 3 kryhet nepermjet Paleve ne konflikt dhe, per deri sa nuk jane ruajtur afatet e percaktuara ne nenin 10 paragrafi 3, çdo Pale ne konflikt ne mungese te nje marreveshjeje tjeter mund t'i lutet Presidentit te Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise ne Paris te beje emertimet e nevojshme. Vendimi i arbitrazhit zbatohet sipas juridiksionit te brendshem shtetror.

3. Pala Kontraktuese pjesemarrrese ne mosmarreveshje gjate arbitrazhit ose zbatimit te nje vendimi arbitrazhi nuk do te shprehe kundërshtim qe shtetasit ose shoqerite e Pales tjeter Kontraktuese te kene marre nje çdemtim per nje pjese te demit ose demin e plote nga nje shoqeri sigurimi.

4. Ne rast se te dy Palet Kontraktuese jane bere edhe shtete kontraktuese te Konventes se 18 marsit 1965 per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve lidhur me Investimet midis Shteteve dhe Shtetasve te tjera, mosmarreveshjet sipas ketij neni ndermjet Paleve ne konflikt do t'i nenshtrohen nje arbitrazhi ne kuadrin e Konventes se Iartpermendur, perveç rastit kur ato bien dakord mbi nje proçedure tjeter; çdo Pale Kontraktuese deklaroi me kete rast mirekuptimin per nje proçedure te tille.

Neni 12

Kjo Marreveshje eshte e vlefshme pavaresisht ne se ndermjet te dy Paleve Kontraktuese ekzistojne apo jo marredhenie diplomatike apo konsullore.

Neni 13

1. Kjo Marreveshje duhet ratifikuar. Instrumentat e ratifikimit do te shkëmbehen sa me shpejt te jete e mundur ne Tirane.

2. Kjo Marreveshje hyn ne fuqi pas nje muaji nga data e shkëmbimit te instrumentave te ratifikimit. Ajo mbetet ne fuqi 10 vjet. Pas mbarimit te ketij afati perioda e vlefshmerise zgjatet pa kufizim, ne rast se asnjera nga Palet Kontraktuese nuk e denoncon Marreveshjen me shkrim 12 muaj para mbarimit te afatit. Pas mbarimit te 10 vjeteve Marreveshja mund te denoncohet ne çdo kohe me nje afat prej 12 muajsh.

3. Per investimet, te cilat jane ndermarre deri ne kohen e mbarimit te afatit te kesaj Marreveshjeje, vlejne nenet 1 deri 12 edhe per 20 vjet te tjera nga data e shfuqizimit te Marreveshjes.

Bere ne Bonn me 31. Tetor 1991 ne dy origjinale, secili ne gjuhen gjermane dhe ne gjuhen shqipe, ku çdo tekst ka vlerë të barabartë.

Per Republikën
Federale të Gjermanisë:
HANS-DIETRICH GENSCHER

Per Republikën
e Shqipërisë:
MUHAMET KAPLLANI

PROTOKOLL

Gjate nënshkrimit të Marrëveshjes ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve, të plotfuqishmit që nënshkruan përveç kësaj rane dakord me dispozitat që vijojnë, të cilat vlejnë si pjesë përberëse e marrëveshjes:

(1) Tek nëni 1

- a) Të ardhurat që rrjedhin nga investimi dhe në rastin e riinvestimit të tyre edhe të ardhurat nga ai gezojnë të njëjten mbrojtje si investimi.
- b) Pa demtuar procedurë të tjera për përcaktimin e shtetësisë, vlen veçanërisht si shtetas i një Pale Kontraktuese çdo person që mban pasaportën kombëtare të leshuar nga organet kompetente të Palës përkatëse Kontraktuese.

(2) Tek nëni 2

- a) Investimet të cilat janë lejuar në përputhje me dispozitat ligjore të njërës Pale Kontraktuese në territorin e zbatimit të rendit të saj ligjor nga shtetas ose shoqëri të Palës tjetër Kontraktuese, gezojnë mbrojtjen e plote të marrëveshjes.
- b) Marrëveshja është e vlefshme gjithashtu për zonën ekskluzive ekonomike dhe shelfin kontinental, përderisa e drejta ndërkombëtare i lejon secilës Pale Kontraktuese ushtrimin e të drejtave sovranë ose të autorizimeve të sovranitetit në këto zona.

(3) Tek nëni 3

- a) "Aktivitet" në kuptimin e nenit 3 paragrafi 2 duhet kuptuar veçanërisht, por jo vetëm, administrata, përdorimi dhe shfrytëzimi i një investimi. Si një trajtim "me pak i favorshëm" sipas nenit 3 duhet kuptuar veçanërisht: një trajtim i diferencuar në terheqjen e lendeve të para dhe ndihmësë, lendeve energjetike dhe djegëse si dhe mjetet e prodhimit dhe punës të të gjitha llojeve, një trajtim i diferencuar në shitjen e prodhimeve brenda dhe jashtë vendit, si dhe masa të tjera me ndikim të ngjashëm. Masat që merren për shkak të sigurimit publik dhe ruajtjes së rendit, shëndetit të popullit ose të moralit, nuk konsiderohen si trajtim "me pak i favorshëm" në kuptimin e nenit 3.

- b) Dispozitat e nenit 3 nuk detyrojnë ndonjë Pale Kontraktuese që avantazhet tatimore, përjashtimet dhe zbritjet nga tatimet, të cilat sipas ligjeve tatimore u sigurohen vetëm personave fizike dhe shoqërive të vendosura në territorin e vet, të shtrijë mbi personat fizike dhe shoqëritë e vendosura në territorin e Pales tjetër Kontraktuese.
- c) Palet Kontraktuese në kuadrin e dispozitave ligjore të brendshme do të shqyrtojnë me dashamirësi kërkesat për hyrjen dhe qëndrimin e personave të njërës Pale Kontraktuese që dëshirojnë të hyjnë lidhur drejtperdrejtë me një investim në territorin e Pales tjetër Kontraktuese; e njëjta gjë vlen për punëmarresit e një Pale Kontraktuese që në lidhje me një investim dëshirojnë të hyjnë në territorin e Pales tjetër Kontraktuese dhe të qëndrojnë atje për të ushtruar një aktivitet si punëmarres. Edhe kërkesat për dhenien e lejes së punës do të shqyrtohen me dashamirësi.

(4) Tek neni 4

Një detyrim për çdemtim qëndron edhe atëherë kur nga marrja e masave shtetërore nderhyet në ndermarrjen e cila përben objekt investimi dhe si rrjedhojë ekzistenca ekonomike e saj demtohet në mënyrë të ndjeshme.

(5) Tek neni 7

Si i kryer "pa vonëse" në kuptimin e nenit 7 paragrafi 1 konsiderohet një transferim që realizohet brenda një periudhe që normalisht është e nevojshme për respektimin e formaliteteve të transferimit. Afati fillon me paraqitjen e një kerkese përkatëse dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të kalojë 2 muaj.

(6) Gjate transportit të mallrave dhe personave që lidhen me një investim, duhet që një Pale Kontraktuese, as të mos i pengojë dhe as të mos i pezullojë ndermarrjet transportuese të Pales tjetër Kontraktuese, por sa të jete e nevojshme të japë leje për kryerjen e transporteve. Këtu behet fjale për:

- a) Mallra që janë caktuar direkt për investime në kuptimin e Marreveshjes ose që janë siguruar në territorin e njërës Pale Kontraktuese ose të një shteti të tretë nga një ndermarrje ose me porosi të një ndermarrje në të cilën janë investuar vlera pasurore në kuptimin e Marreveshjes.
- b) Personat që udhetojnë në lidhje me një investim.

Bere ne Bonn me 31. Tetor 1991 ne dy origjinale, secili ne gjuhen gjermane dhe ne gjuhen shqipe ku çdo tekst ka vlere te barabarte.

Per Republikën
Federale te Gjermanise:
HANS-DIETRICH GENSCHER

Per Republikën
e Shqiperise:
MUHAMET KAPLLANI

EXCHANGE OF NOTES — ÉCHANGE DE NOTES

I

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME
MINISTRI

Bonn, me 31 tetor 1991

Shkelqesi,

Kam nderin t'Ju njoftoj se Qeveria e Republikes se Shqiperise me qellim qe te avancoje sigurimin e investimeve nga shtetas ose shoqeri te Republikes Federale te Gjermanise ne territorin e Republikes se Shqiperise qysh para hyrjes ne fuqi te marrevshjes, paraprakisht zbaton marrevshjen qysh ne ditën e nenshkrimtit.

Kjo deklarate behet me qellim qe qeveria e Republikes Federale te Gjermanise te konsideroje marrjen persiper te garancise per investimet ne Republikën e Shqiperise qysh para hyrjes ne fuqi te kesaj marrevshjeje.

Pranoni Shkelqesi t'Ju shpreh konsideratat e mia me te larta.

MUHAMET KAPLLANI

Ministrit Federal te Puneve te Jashtme
te Republikes Federale te Gjermanise
Zotit Hans-Dietrich Genscher
Bonn

II

DER BUNDESMINISTER DES AUSWÄRTIGEN

Bonn, den 31. Oktober 1991

Herr Minister,

ich beehre mich, den Empfang der Note der Regierung der Republik Albanien vom 31. Oktober 1991 mit folgendem Inhalt zu bestätigen:

„Ich beehre mich, Ihnen mitzuteilen, daß die Regierung der Republik Albanien, um die Vornahme von Kapitalanlagen von Staatsangehörigen oder Gesellschaften der Bundesrepublik Deutschland im Hoheitsgebiet der Republik Albanien bereits vor dem Inkrafttreten des Vertrags zu fördern, den Vertrag vom Tag der Unterzeichnung an vorläufig anwenden wird.

Diese Erklärung wird mit dem Ziel abgegeben, daß die Regierung der Bundesrepublik Deutschland die Übernahme von Garantien für Kapitalanlagen in der Republik Albanien schon vor dem Inkrafttreten dieses Vertrags erwägen kann.“

Genehmigen Sie, Herr Minister, die Versicherung meiner ausgezeichneten Hochachtung.

GENSCHER

An den Minister für Auswärtige Angelegenheit
der Republik Albanien
Herrn Muhamet Kapllani
